



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KRYETARI

Nr. 5705 Prot

Vlorë, më 24.03 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2026

**“PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR TITUJT VENDORË TË NDERIT
DHE TITUJT E VEÇANTË VENDORË TË NDERIT NË BASHKINË VLORË”**

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1.7, shkronja “a”, nenit 54 shkronja “m” të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Nenit 14 të Ligjit nr.94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”; Kreut I, pika “2” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisioneve Këshillimore për dhënie e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr. 56, datë 26.07.2024, “Për Titujt Vendorë të Nderit, Kriteret dhe Procedurën e Dhënies së Tyre si dhe Emërtimin e Rrugëve, Shesheve, Territoreve, Institucioneve dhe Objekteve në Juridiksionin e Bashkisë Vlorë”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____. _____. 2026,

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit Këshillimor për titujt vendorë të nderit dhe titujt e veçantë vendorë të nderit në Bashkinë Vlorë, me këtë përbërje:

- Irena Toshkallari.
- Bardhosh Gaçe.
- Kreshnik Çipi.
- Skënder Spahiu.
- Artur Dhamo.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55/6 të të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR
Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KRYETARI

Nr. 5705 Prot

Vlorë, më 24.03 2026

RELACION

**“PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR TITUJT VENDORË TË NDERIT
DHE TITUJT E VEÇANTË VENDORË TË NDERIT NË BASHKINË VLORË”**

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1.7, shkronja “a”, nenit 54 shkronja “m” të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Nenit 14 të Ligjit nr.94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”; Kreut I, pika “2” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisioneve Këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr. 56, datë 26.07.2024, “Për Titujt Vendorë të Nderit, Kriteret dhe Proceduren e Dhënies së Tyre si dhe Emërtimin e Rrugëve, Shesheve, Territoreve, Institucioneve dhe Objekteve në Juridiksionin e Bashkisë Vlorë”, po ju parashtrojmë relacionin si më poshtë vijon:

Ky relacion hartohet me qëllim miratimin e krijimit nga Këshilli Bashkiak Vlorë, në funksion të detyrimeve ligjore të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të komisionit këshillimor në përputhje me parashikimet e ligjit nr.94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” për të siguruar garantimin e një procesi profesional, të paanshëm dhe transparent në shqyrtimin e propozimeve për titujt vendor të nderit të paraqitura; Vlerësimin objektiv të figurave, personaliteteve dhe subjekteve që kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit; Unifikimin e praktikave dhe kriterëve për dhënien e titujve të nderit; Këshillimin e organeve vendimmarrëse përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga Këshilli Bashkiak.

Projekt Vendimi që ju paraqesim është një detyrim ligjor që rrjedh nga Ligji nr.94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”, neni 14 i tij, si edhe nga V.K.M nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisioneve Këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij kuadri ligjor, ndërmjet të tjerave ligjvënësi ka përcaktuar në çdo fillim viti detyrimin e ngritjes së një Komisioni Këshillimor pranë Këshillit të Bashkisë, i cili është organi që jep tituj vendor nderi dhe tituj të veçantë vendor nderi. Përbërja e këtij Komisioni Këshillimor, bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, miratohet nga Këshilli i Bashkisë dhe në përbërjen e tij duhet të jenë 5 anëtarë, nga të cilët 3 anëtarë punonjës të Bashkisë dhe 2 anëtarë personalitete të jashtme, ekspertë të fushave të

ndryshme. Komisioni Këshillimor, sipas ligjit, administron propozimet për tituj nderi, i vlerëson ato dhe i paraqet Këshillit të Bashkisë mendimin e tij rast pas rasti, të shoqëruar me relacionin përkatës.

Vendimet e këtij Komisioni, të cilat merren me shumicë votash, përveç detyrim ligjor janë një ndihmë për vendimarrjen e Këshillit të Bashkisë, pasi këta anëtarë janë ekspertë të fushave të ndryshme dhe paraprakisht studiojnë dokumentacionin përkatës të subjekteve që propozojnë dhënien e titujve të nderit dhe medaljeve. Për rrjedhojë, vlerësojmë se duhet të zgjidhen persona të spikatur por edhe që janë të angazhuar dhe të përgjegjshëm për detyrat e ngarkuara.

Duke paraqitur këtë Projekt Vendim sjellim në vëmendjen e Këshillit të Bashkisë faktin se Komisioni Këshillimor i fundit është miratuar me vendimin nr.5, datë 29.01.2024, të Këshillit të Bashkisë, ndërsa për vitin 2025 nuk kemi një vendimarrje pavarësisht detyrimit ligjor.

Rezulton se aktualisht në protokollin e Bashkisë janë të administruara shume kërkesa dhe propozime për dhënie tituj nderi, emërtime rrugësh, sheshesh etj, kërkesa të cilat i janë përcjellë Këshillit të Bashkisë. Sa më sipër bën të domosdoshëm krijimin e Komisionit Këshillimor për të vijuar procedurat e mëtejshme të vendimarrjes nga Këshilli i Bashkisë dhe për ti dhënë përgjigje përfundimtare të interesuarve.

Në përbërjen e Komisionit sipas parashikimeve të nenit 14 të Ligjit nr.94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”, kemi propozuar 3 anëtarë punonjës të Bashkisë dhe 2 anëtarë personalitete të jashtme, me kontribute të spikatura në jetën shoqërore, kulturore, akademike ose qytetare. Përbërja synon të sigurojë balancë profesionale, integritet moral dhe ekspertizë në procesin vlerësues. Parë në këtë këndvështrim vlerësojmë se përbërja e këtij komisioni i përmbush kërkesat e ligjit si dhe pritshmëritë e Këshillit të Bashkisë në funksion të një vendimarrje e cila duhet të jetë e pranueshme edhe nga opinioni publik i qytetit.

Në këto kushte, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 94/2022 dhe aktet nënligjore të dala për zbatim të tij, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt, transparent dhe të besueshëm për dhënien e titujve të nderit, vlerësohet e domosdoshme krijimi i Komisionit Këshillimor.

Për sa më sipër, në mbështetje të kuadrit ligjor dhe kompetencave të Bashkisë Vlorë, i kërkojmë Këshillit Bashkiak, në cilësinë e organit vendimarrës miratimin e projektvendimit “Për krijimin e komisionit këshillimor për titujt vendorë të nderit dhe titujt e veçantë vendorë të nderit në Bashkinë Vlorë”.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

KRYETAR
Brunilda MERSINI



REPUBLICAN E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË